




Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka




Drejtori për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.22/350-84668 datë:22.01.2020
REFERENC-Ë:	07Nr.350-84668 datë: 27.12.2019
PËR/TO:	Arben Kuçi, Rruga "Brigada 123" - Suharekë
KOPJE/COPY:	Drejtoria e Inspeksionit, Dosjetë Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTORI: Sanie KUQI
	SHSU: Nexhmije LOSHI DURMISHI
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Leje Ndërtimore

Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-84668 datë: 27.12.2019 nga **Arben Kuçi** nga Suhareka, për Leje Ndërtimore për objektin afaristo-banesor, me etazhitet P+2, në parcelën kadastrale 02355-7, sipas çertifikatës Nr.ref.406/2020 datë 21.01.2020 pronë e Arben Kuçit dhe Valbona Kuçin sipas sipas Autorizimit nga bashkëpronarja Nr.LRP.4373/2019 datë 17.07.2019, andaj pas shqyrtimit të kërkesës ky organ vendos, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 22.01.2020

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.22/350-84668

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, Rregullore për tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr-16-9367, datë 31.12.2014; neni 2, pika 2.1 dhe 2.2 si dhe sipas Planit Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë 05.03.2008, kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga Arben Kuçi -Suharekë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim lëshon këtë :

AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Arben Kuçi	Nr. Personal	[REDACTED]
Adresa:	Rr." Brigada 123", SUHAREKË	Telefoni:	[REDACTED]
Email:		Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje ndërtimore: 07Nr.350-84668, datë:27.12.2019

Emri i Projektit:	OBJEKT AFARISTO-BANESOR		
Emri i Projektuesit:	N.P.N"D-PROJECT", Prizren		
Adresa:	Rr."Komuna e Parisit" Llamella 3 hyrja1 banesa nr.2 , Prizren		
Telefoni:	[REDACTED]	Emaili:	[REDACTED]

Për punët ndërtimore në vijim:NDËRTIM I RI			
Adresa: Rr." Brigada 123",SUHAREKË			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Sipas çertifikatës me nr. të lëndës : 3537/2019, datë 25.07.19, Zona Kadastrale- Suharekë	02355-7	Y= 7485223.5; X=4690427.059 Y= 7485235.22; X=4690410.21	Y= 7485242.57; X=4690415.32 Y= 7485230.86; X=4690432.16

Siperfaqja bruto e objektit:
S=850.49 m²

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Objekt afaristo-banesor			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria II			
Gabariti	20.50 m' x 8.85m'	Katshmëria:	(P+2)
Vija rregullative	Nga aksi i rrugës "Brigada 123" 16.0m' Nga kufiri i rrugës "13 Qershori" 0.00m'	Vija ndërtimore:	Nga aksi i rrugës "Brigada123" 19.0m' Nga aksi i rrugës "13 Qershori" 5.00m'

Përshkrim i

Me këtë vendim, poseduesit të lejës ndërtimore **Arben Kuçinga Suhareka** i lejohet ndërtimi i objektit afarist-banesor me etazhitet P+2.

Lokacioni i objektit është në kuadër të PZHU-së, 01Nr.5820 datë 05.03.2008, ku sipas gjendjes së planifikuar në parcelën kadastrale 02355-7, është tokë ndërtimore me destinim zonë qendrore banimore. Objekti është planifikuar të ndërtohet pranë rrugës "Brigada 123" me destinim banim dhe afarizem sipas hartimit të projektit nga byroja projektuese: N.P.N "D-PROJECT", Prizren.

Objekti ka karakter të përhershëm me katëshmëri (P+2). Ndërtimi i objektit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.684/350-51762, datë: 25.11.2019.

Objekti është lejuar të ndërtohet me gabarit: 20.50 m' x 8.85m' (sipas kushteve të lartcekura).

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejën Ndërtimore;
 - Informata mbi Projektuesin;
 - Informata mbi Kontraktuesin;
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevojat të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;

- Librin dhe ditarine ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
- Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
- Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Ar s y e t i m

Aplikuesi Arben Kuçinga Suhareka, përmes kërkesës 07Nr.350-84668, datë:27.12.2019, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit afarist-banesor, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.684/350-51762, datë: 25.11.2019 (kopje)
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.191/19, datës: 30.12.2019, lëshuar nga NPRM "ECO-REGJIONI"- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Dëshmi për pagesën e taksës sipas njoftimit 07Nr.801/350-84668, datë: 27.12.2019, në shumë prej: 1968.264€, e paguar në Raiffeisen Bank Suharekë, sipas faturës komunale nr.0000469, datë: 22.01.2020.
- Pëlqim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjetllësit dhe Kanalizimit –Hidroregjioni Jugor Prizren Nr.52, datë: 08.01.2020.
- Pëlqimit nga fqinjet të noterizuar mbi të drejtën e ndërtimit në kufij me parcelat fqinjë, Nr.LRP.11262/2019 datë 26.07.2019 dhe Nr.LRP.11438/2019 datë 30.07.2019 .
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor – nga Inspektori i Komunikacionit

Rrugor 09 Nr.530-80860/453, datë: 27.12.2019.

- Pëlqim sanitar – nga Inspektori i Sanitarise 09 Nr.454, datë: 27.12.2019.
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.10, datë: 13.01.2020.
- Pëlqim në dokumentacion teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri, Nr.03/03-127 date 19.12.2019.
- Aktvendim mbi Leje Rrërimi 07 Nr.20/350-85278, datë:22.01.2020(kopje).
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Vërtetimin e tatimit në Pronë
- Kopje e dokumentit Identifikues


Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform PZHU-së 01Nr.5820 datë 05.03.2008, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPH në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.22/350-84668 datë:22.01.2020

Vendimi i dërgohet:
-Parashtruesit të kërkesës;
Inspektoratit të Komunës;
Dosjes së DUP-së

Sanie KUQI

Drejtori i Drejtorisë:


REPUBLIKA E KOSOVës
KOMUNA E SUHAREKËS
Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim